



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 108

11 korrik

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 489, datë 13.6.2013	Për shpalljen e kompleksit natyror të liqeneve të Prespës së Madhe e të Vogël dhe të territoreve përreth zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë.....	4733
Vendim i KM nr. 491, datë 13.6.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 310, datë 21.4.2011 “Për përcaktimin e koston mesatare, lekë për metër katror, për objektet shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi për banorët posedues, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave të periudhës 2009-2011”.....	4736
Vendim i KM nr. 500, datë 22.5.2013	Për përcaktimin e formës së mbështetjes, kriterëve dhe kushteve për përfitim të mbështetjes nga shoqëritë tregtare, të cilat pranojnë nxënës të arsimit profesional publik për të zhvilluar praktikën profesionale.....	4736
Vendim i KM nr. 501, datë 22.5.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.....	4740
Vendim i KM nr. 503, datë 30.5.2013	Për rishpërndarje fondesh, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e vitit 2013.....	4743
Vendim i KM nr. 504, datë 30.5.2013	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës “Kapanoni 22”, me sipërfaqe 290.7 m ² me vendndodhje në komunën Farkë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të Ministria e Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe për një ndryshim në vendimin nr. 413, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)”...	4743

Vendim i KM
nr. 508, datë 13.6.2013

Për disa ndryshime në vendimin nr. 24, datë 9.1.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit në programet e studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2012 - 2013”, të ndryshuar.....

4747

Vendim i KM
nr. 511, datë 13.6.2013

Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 1000 m², të ndodhur në zonën kadastrale 2105, me nr. 1281, fshati Kashar, komuna Kashar, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkuar “K & M-Oil” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....

4749

VENDIM
Nr. 489, datë 13.6.2013

**PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT NATYROR TË LIQENEVE TË PRESPËS SË MADHE
E TË VOGËL DHE TË TERRITOREVE PËRRETH ZONË NATYRORE VEÇANËRISHT E
MBROJTUR DHE PËRFSHIRJEN NË LISTËN E LIGATINAVE ME RËNDËSI
NDËRKOMBËTARE, VEÇANËRISHT SI HABITATE TË SHPENDËVE UJORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 e 4 të Konventës së Ramsarit “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”, të neneve 4/1, pikat 1 e 2, 4/3, pika 1, e 13 të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, pikat 7 e 14 të ligjit nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, me propozimin e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e kompleksit natyror të liqeneve të Prespës së Madhe e të Vogël dhe të territoreve përreth zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen në listën e Konventës së Ramsarit “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e zonës natyrore veçanërisht të mbrojtur janë, si më poshtë vijon:

Veri: Pika 1 te dogana, me koordinata 4491710.92 L dhe 4531669.34 V, vijon gjatë kufirit shtetëror me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, deri te pika 2, kuota 1178.5 m, me koordinata 4497778.10 L dhe 4529977.61 V;

Lindje: Pika 2, kuota 1178.5 m, me koordinata 4497778.10 L dhe 4529977.61 V, vijon gjatë kufirit shtetëror me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me Greqinë, pika 3, kuota 889.5 m, pika 4 (mali i Gagazit), kuota 1326.4 m deri te pika 5, kuota 1547.7 m, me koordinata 4504975.15 L dhe 4503812.55 V;

Jug: Pika 5, kuota 1547.7 m, me koordinata 4504975.15 L dhe 4503812.55 V, vijon me kufirin e Parkut Kombëtar “Prespa”, pika 6 (maja e Kalasë së Trojanit), kuota 1188.0 m, deri te pika 7 (mali i Osojës), kuota 1335.9 m, me koordinata 4498389.01 L dhe 4505964.24 V;

Perëndim: Pika 7 (mali i Osojës), kuota 1335.9 m, me koordinata 4498389.01 L dhe 4505964.24 V, zbrit kurrizin në drejtim të kuotës 1072.0 m, ndjek krahun e poshtëm të rrugës, kalon te Qafa e Lisave, poshtë fshatit Rakickë, vijon me rrugën në drejtim të qafës së Çukës dhe të fshatit Zaroshkë, i ngjitet kurrizit në drejtim të pikës 8, kuota 1278.2 m (m. Vërtellkës), zbrit te kuota 889.0 m, i ngjitet kurrizit në drejtim të kuotës 1132.1 m (maja e Padinës), pika 9, me koordinata 4490412.41 L dhe 4513756.10 V, ndjek anën e poshtme të rrugës në drejtim të fshatit Gollomboç; deri te pika 10, me koordinata 4494260.71 L dhe 4524540.87 V, i ngjitet kurrizit në drejtim të kuotave 1088.0 m, 1065.0 m, 1163.0 m (m. Hata-Drushit), 1108,0 m, 964.0 m, pika 11, kuota 1040.0 m, me koordinata 4491661.23 L dhe 4527638.41 V, zbrit kurrizin në drejtim të kuotave 925.0 m, 9809 m e të pikës 12, me koordinata 4493116.41 L dhe 4529349.63 V, vijon gjatë rrugës në drejtim të doganës deri te pika 1, me koordinata 4491710.92 L dhe 4531669.34 V.

3. Zona natyrore veçanërisht e mbrojtur ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 15 118.58 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e tetë) ha dhe ndahet, si më poshtë vijon:



Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja në ha
1.	Sipërfaqe ujore (liqene, laguna, lumenj, përrenj)	5 235.45
2.	Sipërfaqe pyjore, shkurre dhe tokë me bimësi pyjore	7 262.40
3.	Sipërfaqe me kullota dhe livadhe	320.17
4.	Sipërfaqe bujqësore (arë, pemëtore, vreshta)	2 133.23
5.	Sipërfaqe joproduuese (shkëmbore, zhavorre, ranore, rrugë)	13.40
6.	Sipërfaqe urbane	133.38
7.	Sipërfaqe urbane të përzier me tokë bujqësore	20.55
	Sipërfaqja e përgjithshme	15 118.58

4. Zonimi i territorit të zonës natyrore veçanërisht të mbrojtur është në përputhje me zonimin e territorit të Parkut Kombëtar “Prespa”, të përcaktuar në planin e menaxhimit të parkut.

5. Veprimtaritë social-ekonomike që lejohen të ushtrohen në zonën natyrore veçanërisht të mbrojtur, në përputhje me Konventën e Ramsarit, janë ato me karakter tradicional, që ruajnë vlerat mjedisore dhe që zhvillohen në përputhje me nivelin e mbrojtjes së zonës dhe me objektivat e planit të menaxhimit të parkut kombëtar.


6. Administrata e Parkut Kombëtar “Prespa”, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, përgjigjet për ruajtjen dhe menaxhimin e zonës natyrore veçanërisht të mbrojtur, si habitate të shpendëve ujorë sipas Konventës së Ramsarit, në kuadër të programeve dhe planit të menaxhimit për parkun kombëtar.

Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Prespa” mbikëqyr veprimtarinë e administratës së parkut kombëtar dhe në kuadrin e ruajtjes dhe të menaxhimit të zonës natyrore veçanërisht të mbrojtur si habitat të shpendëve ujorë në përputhje me Konventën e Ramsarit.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha





VENDIM

Nr. 491, datë 13.6.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.4.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E KOSTOS MESATARE, LEKË PËR METËR KATROR, PËR OBJEKTET SHETËRORE TË TRANSFORMUARA NË FOND BANESASH, KALUAR NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE, ME QËLLIM PRIVATIZIMI PËR BANORËT POSEDUES, SIPAS VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË PERIUdhËS 2009-2011”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe të nenit 34/1 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit në zonat urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit nr. 310, datë 21.4.2011 të Këshillit të Ministrave, togfjalëshi “...periudhës 2009-2011...” zëvendësohet me “...periudhës 2009-2013...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 500, datë 22.5.2013

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS SË MBËSHETETJES, KRITEREVE DHE KUSHTEVE PËR PËRFITIMIN E MBËSHETETJES NGA SHOQËRITË TREGTARE, TË CILAT PRANOJNË NXËNËSIT E ARSIMIT PROFESIONAL PUBLIK PËR TË ZHVILLUAR PRAKTIKËN PROFESIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17, pika 2, dhe 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 18 e 32 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit që ndjekin arsimin profesional publik kryejnë praktikën profesionale pranë shoqërive tregtare nën udhëheqjen e një mentori të saj, për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh ose 6 (gjashtë) javësh mësimore, konform programit dhe kurrikulës përkatëse të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2. Numri i nxënësve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, në sistemin publik të arsimit dhe formimit profesional, përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përkatësisht brenda muajit shtator të çdo viti shkollor, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve përzgjedh shoqëritë tregtare që do të përfshihen në sistemin e AFP-së, sipas listës së publikuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimeve.

4. Përfshirja e shoqërive tregtare në këtë veprimtari realizohet me anë të një kontrate që lidhet ndërmjet institucioneve arsimore ofruese të arsimit profesional ose prindërve të nxënësve dhe shoqërive tregtare. Praktika profesionale mund t'u ofrohet përfituesve/institucioneve arsimore nëpërmjet kontratave të sponsorizimit të nënshkruara me shoqëritë tregtare.

5. Modeli i kontratës për kryerjen e praktikave profesionale të nxënësve pranë shoqërive tregtare hartohet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve. Kontrata duhet të përmbajë detyrimet dhe të drejtat e shoqërisë tregtare, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si edhe me përcaktimet e ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", të ndryshuar.

6. Shoqëritë tregtare përfshihen në sistemin e arsimit dhe formimit profesional (AFP) nëpërmjet:

a) pranimit të nxënësve të shkollave profesionale publike për kryerjen e praktikave profesionale;

b) mbështetjes me burime njerëzore që shoqëritë tregtare publike ose private u ofrojnë shkollave profesionale publike për të krijuar akses për kryerjen e praktikave profesionale;

c) vënies në dispozicion të materialeve, pajisjeve teknologjike të nevojshme për realizimin e praktikës profesionale, në përputhje me programet përkatëse.

7. Shoqërive tregtare, të cilat pranojnë nxënësit e shkollave profesionale publike për të zhvilluar praktikën mësimore, në kuadër të programit mësimor përkatës, shpenzimet e personelit për mentorët/instruktorët që udhëheqin praktikat profesionale të nxënësve praktikantë, shpenzimet e tjera për materiale, vegla pune, veshje për mbrojtjen në punë të nxënësve, si dhe të tjera materiale sipas profilit të praktikës profesionale, u konsiderohen si shpenzime të njohura konform paragrafit të 2-të të nenit 18 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

8. Shpenzimet e njohura për shoqëritë tregtare, sipas pikës 7 të këtij vendimi, nuk duhet të kalojnë këto kosto mesatare ditore:

a) për çdo praktikant të klasës së 10-të, 250 (dyqind e pesëdhjetë) lekë;

b) për nxënësit praktikantë të klasës së 11-të, 300 (treqind) lekë;

c) për nxënësit praktikantë të klasës së 12-të, 350 (treqind e pesëdhjetë) lekë;

ç) për nxënësit praktikantë të klasës së 13-të, 400 (katërqind) lekë.

Në asnjë rast këto shpenzime nuk duhet të tejkalojnë kufirin e shpenzimeve të njohura sipas përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", të ndryshuar.

9. Shpenzimet për pagesën e primit të sigurimit të jetës nga aksidentet në punë, për nxënësit praktikantë gjatë periudhës së kryerjes së praktikës profesionale, mbulohen nga fonde të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në programin buxhetor të arsimit profesional.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Aneksi nr. 1. Të dhëna për numrin e nxënësve që do të kryejnë praktikën profesionale në biznes dhe ditë në praktikë për vitin akademik 2012-2013							
Nr. drejt. studimit	Drejtimi i studimeve në arsimin profesional	Numri i nxënësve për çdo klasë dhe drejtim studimi për vitin akademik 2012-2013					Ditë praktike për çdo klasë dhe drejtim studimi
		Totali	klasa 10	klasa 11	klasa 12	klasa 13	
6	Hoteleri - Turizëm (viti 1)	637	637				30
	Hoteleri - Turizëm (viti 2)	417		417			30
	Kuzhinë-Pastiçeri (viti 3)	109			109		30
	Bar-restorant (viti 3)	187			187		30
	Turizëm (viti 3)	0			0		30
	Reception (viti 3)	36			36		30
	Guidë Turistike (viti 3)	0			0		30
	Hoteleri - Turizëm (viti 4)	306				306	30
5	Tekstil-Konfeksion (viti 1)	43	43				30
	Tekstil-Konfeksion (viti 2)	30		30			30
	Rrobaqepësi (viti 3)	0			0		30
	Tekstil (viti 3)	34			34		30
	Modelim (viti 3)	0			0		30
	Galanteri (viti 3)	8			8		30
	Tekstil-Konfeksion (viti 4)	39				39	30
5	Mekanikë (viti 1)	298	298				30
	Mekanikë (viti 2)	315		315			30
	Makina metalpunuese (viti 3)	199			199		30
	Konstruksione metalike (viti 3)	158			158		30
	Metalurgji dhe fonderi (viti 3)	143			143		30
	Mirëmbajtje dhe riparime mekanike (viti 3)	137			137		30
	Mekanikë (viti 4)	229				229	30
6	Shërbime mjeteve transporti (viti 1)	798	798				30
	Shërbime mjeteve transporti (viti 2)	516		516			30
	Shërbime elektroauto (viti 3)	139			139		30
	Shërbime xhenerike (viti 3)	65			65		30
	Shërbime motori (viti 3)	235			235		30
	Shërbime karrocierie (viti 3)	0			0		30
	Shërbime mjeteve transporti (viti 4)	255				255	30
5	Elektronikë (viti 1)	144	144				30
	Elektronikë (viti 2)	111		111			30
	Telekomunikacion (viti 3)	0			0		30
	Riparime të pajisjeve elektronike (viti 3)	65			65		30
	Mekatronikë (viti 3)	0			0		30
	Elektronikë (viti 4)	82				82	30
1	Instalues i sistemeve termohidraulike (Pilot AlbVET) (viti 1)	236	236				30
	Instalues i sistemeve termohidraulike (viti 2)	221		221			30
	Instalues i sistemeve termohidraulike (viti 3)	210			210		30
	Instalues i sistemeve termohidraulike (viti 4)	31				31	30
2	Përpunim druri (viti 1)	70	70				30
	Përpunim druri (viti 2)	45		45			30
	Mobileri - Tapiceri (viti 3)	46			46		30
	Përpunim druri (viti 4)	50				50	30
4	Ndërtim (viti 1)	55	55				30
	Ndërtim (viti 2)	37		37			30
	Muratim - Suvatim (viti 3)	0			0		30
	Shtrim dhe veshje me pllaka (viti 3)	14			14		30
	Karpentieri, hekurkthim dhe betonim (viti 3)	19			19		30
	Punime dhe riparim rrugësh (viti 3)	0			0		30
	Ndërtim (viti 4)	56				56	30

6	Teknologji Ushqimore (viti 1)	311	311				30
	Teknologji Ushqimore (viti 2)	150		150			30
	Teknologji e përpunimit të qumështit (viti 3)	0			0		30
	Teknologji e përpunimit të brumërave (viti 3)	62			62		30
	Teknologji e përpunimit të fruta perimeve (viti 3)	0			0		30
	Teknologji e prodhimit të pijeve alkoolike (viti 3)	23			23		30
	Teknologji e përpunim i mishit dhe peshkut (viti 3)	9			9		30
	Teknologji Ushqimore (viti 4)	76				76	30
9	Bujqësi (viti 1)	89	89				30
	Bujqësi (viti 2)	167		167			30
	Ferma bujqësore dhe blegtorale (viti 3)	44			44		30
	Mbarështim të kafshëve dhe shpendëve (viti 3)	0			0		30
	Mekanizim i Bujqësisë (viti 3)	16			16		30
	Prodhim shtazor (viti 3)	0			0		30
	Prodhim bimor (viti 3)	15			15		30
	Hortikulturë dhe mbrojtje bimësh (viti 3)	0			0		30
	Frutikulturë (viti 3)	29			29		30
	Akuakulturë (viti 3)	52			52		30
4	Bujqësi (viti 4)	102				102	30
	Shërbime Social - Shëndetësore (viti 1)	78	78				30
	Shërbime Social - Shëndetësore (viti 2)	59		59			30
	Shërbime kujdesi për fëmijë (viti 3)	30			30		30
	Shërbime kujdesi për të moshuar (viti 3)	30			30		30
	Shërbime sociale (viti 3)	0			0		30
	Animim social (viti 3)	0			0		30
6	Shërbime Social - Shëndetësore (viti 4)	31				31	30
	Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) (viti 1)	683	683				30
	Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) (viti 2)	494		494			30
	Mbështetje të përdoruesve të TIK-ut (viti 3)	369			369		30
	Rrjete të dhënash (viti 3)	160			160		30
	Zhvillim Website (viti 3)	191			191		30
	Multimedia (viti 3)	167			167		30
	Mbështetje të përdoruesve të TIK-ut (viti 4)	218				218	30
	Rrjete të dhënash (viti 4)	145				145	30
	Zhvillim Website (viti 4)	101				101	30
7	Multimedia (viti 4)	101				101	30
	Ekonomist - Biznes (viti 1)	671	671				30
	Ekonomist - Biznes (viti 2)	578		578			30
	Llogari (viti 3)	338			338		30
	Tregti (viti 3)	0			0		30
	Shërbime bankare (viti 3)	145			145		30
	Sigurime (viti 3)	0			0		30
	Tatim - Taksa (viti 3)	0			0		30
	Sipërmarrje e Agjencisë turistike (viti 3)	0			0		30
	Llogari (viti 4)	352				352	30
	Tregti (viti 4)	0				0	30
	Shërbime bankare (viti 4)	101				101	30



	Sigurime (viti 4)	0				0	30
	Tatim - Taksa (viti 4)	0				0	30
	Sipërmarrje e Agjencisë turistike (viti 4)	0				0	30
	Pyje (viti 1)	20	20				30
	Pyje (viti 2)	21		21			30
	Shfrytëzim pyjesh (viti 3)	0			0		30
	Mbrojtje mjedisi pyjor (viti 3)	0			0		30
	Silvikulturë (viti 3)	15			15		30
	Florikulturë (viti 3)	0			0		30
	Shfrytëzim pyjesh (viti 4)	0			0		30
	Mbrojtje mjedisi pyjor (viti 4)	0			0		30
	Silvikulturë (viti 4)	15				15	30
	Florikulturë (viti 4)	0				0	30
5	Veterinari (viti 1)	59	59				30
	Veterinari (viti 2)	47		47			30
	Veterinari (viti 3)	27			27		30
	Veterinari (viti 4)	49				49	30
	Gjeodezi (viti 1)	12	12				30
	Gjeodezi (viti 2)	9		9			30
	Gjeodezi (viti 3)	31			31		30
	Gjeodezi (viti 4)	33				33	30
	Administrim zyre (viti 1)	29	29				30
	Administrim zyre (viti 2)	0	0	0	0	0	30
	Administrim zyre (viti 3)	0	0	0	0	0	30
	Administrim zyre (viti 4)	0	0	0	0	0	30
	TOTALI	13,379	4,233	3,217	3,557	2,372	3,660

VENDIM

Nr. 501, datë 22.5.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT “PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 108 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas nenit 96 të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet neni 96/1, si më poshtë vijon:

“Neni 96/1

1. Produktet energjetike sipas aneksit 24 që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat importohen (hidhen për qarkullim të lirë) ose blihen pranë magazinave fiskale të prodhimit brenda vendit dhe që kanë destinacion mbajtjen (magazinimin) e tyre me qëllim lëvizjen e mëvonshme drejt pikave të shitjes me pakicë, detyrimisht futen në një magazinë fiskale stokimi me detyrim akcize të pezulluar.

2. Për qëllime të këtij vendimi, do të konsiderohen pika shitjeje me pakicë edhe depozitat e kompanive që i përdorin këto produkte energjetike për nevoja të furnizimit të automjeteve të tyre apo ushtrimit të aktivitetit.

3. Automjetet që kryejnë transportin e produkteve të listuara në aneksin 24, gjatë lëvizjes së tyre duhet të kenë, detyrimisht, një nga dokumentet, sipas rasteve të mëposhtme:

a) Për lëvizjen nga importi në magazinë stokimi - DAV importi për hedhje në qarkullim të lirë me akcizë të pezulluar.

b) Për lëvizjen nga importi direkt në pikë shitjeje me pakicë - DAV importi për hedhje në qarkullim të lirë me detyrime të paguara.

c) Për lëvizjen nga magazina e prodhimit në magazinën e stokimit - DSHA me detyrim akcize të pezulluar.

ç) Për lëvizjen nga magazina e prodhimit në pikat e shitjes me pakicë - DSHA me detyrim akcize të paguar.

d) Për lëvizjen nga magazinat e stokimit në pikat e shitjes me pakicë - DSHA me detyrime të paguara.

4. Mbajtja e dokumenteve të mësipërme nuk përjashton mbajtjen e dokumenteve të tjera tatimore, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

5. Pikat e shitjes me pakicë, për çdo furnizim, duhet të mbajnë kopje të një prej dokumenteve të përmendura në pikën 2 të këtij neni, dhe t'i regjistrojnë në një regjistër të veçantë.

6. Çdo subjekt akcize, që aktualisht trajton produktet sipas specifikimeve të pikës 1 të këtij neni, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të ketë vetëdeklaruar dhe dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave inventarin e produkteve energjetike, gjendje, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Një kopje e këtij inventari duhet të dorëzohet në adresë të degës doganore territorialisht kompetente.

7. Për këto subjekte akcize, gjendja e sasisë së stokuar sipas vetëdeklarimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, regjistrohet në magazinat fiskale nëpërmjet dokumentit DSHA, si hyrje në kontabilitetin e stokut të magazinës fiskale të stokimit.

8. Në zbatim të këtij neni, autoriteti doganor ushtron kontrolle pranë operatorëve që ushtrojnë aktivitetet e parashikuara në këtë nen, me qëllim verifikimin e vetëdeklarimit të bërë prej tyre.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Aneksi 24

Kategoria	Pershkrimi	Kodi NK
E400	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi 50 lekë/litri	27101211
E410	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër, Me më pak se 95 oktan, Me 95-98 oktan, Me 98 e më shumë oktan	27101241
		27101245
		27101249
E420	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër, Me më pak se 98 oktan; Me 98 e më shumë oktan	27101251
		27101259
E430	Vajguret. Karburantet, tip vajguri	27101911
		27101915
		27101921
		27101925
		27101929
E440	Vajra të rënda (gazoil)	27101931
		27101935
		27101943
		27101946
		27101947
		27101948
E450	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	27101951
		27101955
		27101962
		27101964
		27101968
E460	Biodiesel me vajra nafte	27102011
		27102015
		27102017
		27102019
		27102031
		27102035
		27102039
		27102090
E920	Acidet yndyrore/ Biodiesel me më pak se 70 për qind, vajra nafte të kapitullit 27	38260010
		38260090

VENDIM
Nr. 503, datë 30.5.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 16 e 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e vitit 2013, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09770 “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, zëri “Shpenzime korente”, të zbritet fondi prej 25 700 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 09450 “Arsimi i lartë”, zëri “Shpenzime korente”, të shtohet fondi prej 25 700 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 09240 “Arsimi profesional”, zëri “Shpenzime kapitale”, të zbritet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

ç) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, zëri “Shpenzime kapitale”, të zbritet fondi prej 29 000 000 (njëzet e nëntë milionë) lekësh.

d) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, zëri “Shpenzime kapitale”, të shtohet fondi prej 49 000 000 (dyzet e nëntë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 504, datë 30.5.2013

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS “KAPANONI
22”, ME SIPËRFAQE 290.7 M² ME VENDNDODHJE NË KOMUNËN FARKË, NGA
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT TE
MINISTRIA E BRENDSHME, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË
SHTETIT DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME (DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës “Kapanoni 22”, me sipërfaqe 290.7 (dyqind e nëntëdhjetë pikë shtatë) m², nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të Ministria e Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për sistemimin e Stacionit të Policisë, Farkë, sipas planimetrisë dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi (pjesa e ngjyrosur).

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit, e miratuar me vendimin nr. 413, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, dhe t’i shtohet listës së inventarit të pronave që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.

3. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE (të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore										
Bashkia/komuna: FARKË, RRETHI TIRANË										
Fusha e përdorimit të pronës: REZERVË SHETËTË										
A			B				C			
Nr. rendor	Zona kadastral e Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhënat (shënime)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Agjencia Lundër, komuna Farkë Veri: lagjja “Daçi” Jug: Fusha e Monit Lindje: Lagjja Xix Për: Pronar Bim	Truall Ndërtesë zyre, 2 kat Ndërtesë + mbulesë Peshoreje Pallat, banimi, 2 kat Dhoma e rojeve Kabina elektrike Dhomë për punëtorë 1 kat me çati tjegulle Magaz. përdorimit 1 kat me çati eterniti Kapan, 1 kat ç. eterniti	Brenda territorit Brenda territorit Brenda territorit Brenda territorit Brenda territorit Brenda territorit Brenda territorit Brenda territorit Brenda territorit	105000 106.4 6005 293.3 7.8 28 48.4 344.52 290.7	Vendosja e objektit Për zyra Për peshim Për banim Për roje Për ndriçim Për pushim të punëtorëve Mallra dhe materiale në përdorim Për makina	DPRSH DPRSH DPRSH DPRSH DPRSH DPRSH DPRSH DPRSH DPRSH	DR Tiranë DR Tiranë DR Tiranë DR Tiranë DR Tiranë DR Tiranë DR Tiranë DR Tiranë DR Tiranë	



AXHENSIA - *Sunder* -
SHKALLA 1:2000



Legjenda

- | | |
|-----------------------|---|
| -Depo nr 1 | Tatim Taksa, Dega Tirane |
| -Depo nr 2 | KOZ, kodim kapital |
| -Depo nr 3 | Rezerva Shtetërore, (Materiale Ushtarake) |
| -Depo nr 4 | KOZ, kodim kapital, e rikonstruktuar |
| -Depo nr 5 | Qendra Stefan, me qera |
| -Depo nr 6 | Rezerva Shtetërore - detyrgjent, sapun |
| | konfiskim (pije) |
| | automjete, etj. |
| -Depo nr 7 | Djegur me 1997 |
| -Depo nr 8 | Rezerve Shtetërore Ushqimore. |
| -Depo nr 9 | Djegur me 1997 |
| -Depo nr 10 | Djegur me 1997 |
| -Depo nr 11 | Djegur me 1997 |
| -Depo nr 12 | Konfiskime (Pije, Motorra barkash etj) |
| -Depo nr 13 | Materiale Nderitimi (Dyer etj, automjete te ndryshme) |
| -Depo nr 14 | Rezerva Shtetërore - Carcase, pambis |
| | mjete shendetesore, |
| | konfiskime |
| -Depo nr 15 | Depo helmesh |
| -Dhome nr 16 | Dhome punetoresh |
| | 1/2 e shkaterruar |
| -Depo nr 17 | Per perdorim te inventarit ditor |
| | 1/2 e shkaterruar |
| -Depo Vaji nr 18 | Depo nentokësore (2 cope) |
| -Rep.marang. nr 19 | Jashite rrethimit |
| | 1/2 e shkaterruar |
| -Peshore nr 20 | |
| -Zyrat e admin. nr 21 | Per strehimin e mjeteve te Deges |
| -Kapanon nr 22 | 23,24,25 Perdoret nga policia per |
| -Kapanon nr 23 | automjete ne proces (Folicia Kriminale) |
| -Kapanon nr 24 | |
| -Kapanon nr 25 | |
| -Verbiqje nr 26 | |

VENDIM
Nr. 508, datë 13.6.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 24, DATË 9.1.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFAVE TË
SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË, TË
DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN
AKADEMIK 2012 - 2013”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 24, datë 9.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të tretë të studimeve, të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2012 - 2013, gjithsej 1531, të ndara si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Për kandidatët brenda vendit | 1337; |
| b) Për kandidatët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 182; |
| c) Për shtetasit e huaj | 12”. |

b) Tabela nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, TABELA NR. 1

KUOTAT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË DOKTORATËS, PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013

UNIVERSITETI	ID PROG RAMI	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Kuota për kandidatët brenda vendit	Kuota për kandidatët nga trojet
Universiteti i Tiranës	1	Biologji e Ruajtjes	10	2
Universiteti i Tiranës	2	Biologji Molekulare	10	2
Universiteti i Tiranës	3	Fizikë	8	2
Universiteti i Tiranës	4	Bioteknologji Bimore	10	2
Universiteti i Tiranës	5	Elektrokimi e Zbatuar dhe Dukuritë Siperfaqësore	6	2
Universiteti i Tiranës	6	Analiza Kimike e Lëndës dhe Mjedisit	6	2
Universiteti i Tiranës	7	Teknologjia dhe Mikrobiologjia e Ushqimeve dhe Vlerësimi i Sigurisë dhe Cilësisë	5	2
Universiteti i Tiranës	8	Proceset e Trajtitimit Kimik të Lëndëve të Para Natyrore dhe të Mbeturinave Industriale e Urbane	6	2
Universiteti i Tiranës	9	Analizë dhe Algjebër	10	2
Universiteti i Tiranës	10	Metodat Probabilitare, Statistike dhe Metodat e Analizës Numerike	10	2
Universiteti i Tiranës	11	Informatikë	12	3
Universiteti i Tiranës	12	Shkenca Gjuhësore	35	5
Universiteti i Tiranës	13	Letërsi Botërore	18	2
Universiteti i Tiranës	14	Kërkime Gjuhësore	30	5
Universiteti i Tiranës	15	Studime Letrare	17	3
Universiteti i Tiranës	16	Histori	20	2
Universiteti i Tiranës	17	Gjeografi	28	2
Universiteti i Tiranës	18	Histori me drejtim në Arkeologji	4	2
Universiteti i Tiranës	19	Histori me drejtim në Trashëgimi Kulturor	12	2
Universiteti i Tiranës	20	Histori me drejtim në Marrëdhënie Nderkombetare	23	2
Universiteti i Tiranës	21	Gazetari	14	1
Universiteti i Tiranës	22	Pedagogji	19	1
Universiteti i Tiranës	23	Psikologji	19	1
Universiteti i Tiranës	24	Filozofi	14	1
Universiteti i Tiranës	25	Punë Sociale	19	1
Universiteti i Tiranës	26	Sociologji	14	1
Universiteti i Tiranës	27	Shkenca Politike	19	1
Universiteti i Tiranës	28	Shkenca Juridike Civile	34	3
Universiteti i Tiranës	29	Shkenca Penale	34	3
Universiteti i Tiranës	30	E Drejta Publike	33	3
Universiteti i Tiranës	31	Ekonomiks	19	1
Universiteti i Tiranës	32	Menaxhim	20	1
Universiteti i Tiranës	33	Marketing	19	1
Universiteti i Tiranës	34	Metodat Sasiore dhe të Informacionit	14	1
Universiteti i Tiranës	35	Financë	19	1
Universiteti i Tiranës	36	Kontabilitet	19	1
Universiteti i Tiranës	37	Kërkime Operacionale	19	1
Universiteti i Tiranës	38	Statistika	19	1
Universiteti i Tiranës	39	Legjislacion dhe Institucionet e BE-së	18	2
Universiteti i Tiranës	40	Politika dhe Qeverisja në Europë	18	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	41	Diplomacia dhe Marrëdhëniet Nderkombetare të BE	18	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	42	Sëmundje Kirurgjikale	19	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	43	Sëmundjet e Brendshme	18	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	44	Mjeku i Familjes	5	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	45	Stomatologji	11	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	46	Studime të Thelluara të Aspektive Epidemiologjike Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës	13	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	47	Studime në Obstetrikë Gjinekologji	16	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	48	Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji	4	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	49	Sëmundjet e Syrit	4	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	50	Imazheri	7	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	51	Lëndët Biomjekësore-Eksperimentale	9	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	52	Kardiokirurgji	7	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	53	Studime në Neuroshkenca	10	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	54	Shkenca Farmaceutike	13	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	55	Morfologji Klinike	14	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	56	Mjekësi Laboratorike	9	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	57	Pediatri	10	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	58	Shëndet Publik	14	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	59	Studime të Thelluara në Kardiologji	2	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	60	Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore	5	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	61	Shkenca Infermiere me profil: Infermieri	10	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	62	Shkenca Infermiere me profil: Mami	10	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	63	Shkenca Infermiere me profil: Fizioterapi	10	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	64	Shkenca Infermiere me profil: Logopedi	10	1

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	65	Shkenca Infermiere me profil: Teknikë Laboratori	10	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	66	Shkenca Infermiere me profil: Teknikë Imazherie	10	1
Universiteti Politeknik i Tiranës	67	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	14	1
Universiteti Politeknik i Tiranës	68	Inxhinieri Ndërtimi	15	4
Universiteti Politeknik i Tiranës	69	Arkitekturë - Urbanistike	14	4
Universiteti Politeknik i Tiranës	70	Gjeodezi	12	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	71	Gjeoshkenca, Burimet dhe Mjedis	15	4
Universiteti Politeknik i Tiranës	72	Inxhinieri Matematike	8	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	73	Inxhinieri Fizike	8	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	74	Inxhinieri Mekanike	10	6
Universiteti Bujqësor i Tiranës	75	Bujqësia dhe Mjedis, me drejtim në Shkencat Agronomike	10	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	76	Bujqësia dhe Mjedis, me drejtim në Shkencat e Prodhimit Shtazor	10	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	77	Bujqësia dhe Mjedis, me drejtim në Shkencat e Hortikulturës	10	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	78	Bujqësia dhe Mjedis, me drejtim në Shkencat Mjedisore	10	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	79	Bujqësia dhe Mjedis, me drejtim në Shkencat e Mbrojtjes së Bimëve	10	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	80	Ekonomi dhe Agrobiznes me drejtim në Drejtim Agrobiznesi	15	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	81	Ekonomi dhe Agrobiznes me drejtim në Ekonomi dhe Politike Agrare	15	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	82	Ekonomi dhe Agrobiznes me drejtim në Financë-Kontabilitet	15	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	83	Shkencat dhe Bioteknologjia Ushqimore	10	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	84	Shkencat pyjore me drejtim në Qeverisja e Qendrushme e Burimeve Pyjore dhe Kullosore	10	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	85	Shkencat pyjore me drejtim në Teknologjia e Drurit	9	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	86	Mjekësi Veterinare	14	3
Qendra e Studimeve Albanologjike	87	Shkencat Gjuhësore	14	3
Qendra e Studimeve Albanologjike	88	Shkencat Etnologjike dhe Folklor	16	4
Qendra e Studimeve Albanologjike	89	Shkencat Historike	17	3
Qendra e Studimeve Albanologjike	90	Shkencat Arkeologjike	10	2
Qendra e Studimeve Albanologjike	91	Shkencat Letrare	16	3
Qendra e Studimeve Albanologjike	92	Historia e Arteve Shqiptare	11	7
Universiteti "A. Moisiu" Durrës	93	Shkencat Ekonomike	10	2
Universiteti "I. Qemali" Vlorë	94	Matematikë	13	2
Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan	95	Albanologji në profilin "Histori"	9	1
Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan	96	Albanologji në profilin "Gjuhë"	9	1
Universiteti "L. Gurakuqi" Shkodër	97	Gjuhë Shqipe	8	2
Universiteti "F.S.Noli" Korçë	98	Hortikulturë e Qendrushme	9	1
Universiteti i Sporteve të Tiranës	99	Shkenca Sportive	10	3
		TOTALI	1337	182

VENDIM

Nr. 511, datë 13.6.2013

PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 1000 M², TË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2105, ME NR.1281, FSHATI KASHAR, KOMUNA KASHAR, TIRANË, QË DO TË TJETËRISOHET NË FAVOR TË SUBJEKTIT KËRKUES "K & M-OIL" SHPK, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të pikës 4 të vendimit nr. 12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e së drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr. 1281, në zonën kadastrale 2105, fshati Kashar, komuna Kashar, Tiranë, me indeks harte K-34-38 (232-C), me sipërfaqe 1000 (një mijë) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkuar "K & M-Oil" sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të përlllogarit sipas vendimit nr. 187, datë 6.3.2013 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë", duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkuar.



3. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “K & M-Oil” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 11.7.2013
Doli nga shtypi më 11.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 26 lekë